LIGJ
Nr.8379, datë 29.7.1998

PËR HARTIMIN DHE ZBATIMIN E BUXHETIT TË SHTET TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
PËRKUFIZIME TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Ky ligj përcakton parimet që do të udhëheqin përgatitjen, propozimin dhe miratimin e buxhetit të shtetit dhe përgjegjësitë për realizimin e tij.

Neni 2

2.1. "Buxheti i shtetit" është programi financiar vjetor i cili përbëhet nga fondet e miratuara me ligj nga Kuvendi Popullor, në të cilin përfshihen të gjitha të ardhurat, huat dhe hyrjet e tjera, si dhe shpenzimet përkatëse për ushtrimin e veprimtarive dhe kompetencave të organeve të larta të pushtetit shtetëror, të administratës shtetërore, të organeve të pushtetit lokal dhe të pushtetit gjyqësor.

Buxheti i shtetit është instrument financiar kryesor për zbatimin e politikave ekonomike dhe sociale të shtetit.

2.2 "Buxheti i pushtetit lokal" është programi kryesor financiar vjetor i pushtetit lokal në të cilën përfshihen të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet të përcaktuara me ligj për kryerjen e funksioneve që kanë organet e pushtetit lokal në territorin ku ato veprojnë. Buxheti lokal përbëhet nga pjesa e buxhetit të pavarur dhe pjesa që financohet nga buxheti i shtetit.

2.3 " Fondi i miratuar" është e drejta që jepet nga buxheti i shtetit për të përdorur një fond të caktuar gjatë një periudhe të caktuar.

2.4 "Fonde" janë ato të ardhura të llojeve të ndryshme, të cilat përdoren për kryerjen e shpenzimeve sipas këtij ligji.

2.5. "Fond i konsoliduar" është fondi në të cilën përfshihen të gjitha të ardhurat nga buxheti i shtetit dhe drejtimet e përdorimit të tij.

2.6. "Fonde speciale" janë fondet e krijuara nga të ardhurat tatimore dhe jotatimore, të cilat financojnë veprimtari specifike. Fonde speciale janë fondet e institucioneve të krijuara me ligj, veprimtaria e të cilave financohet nëpërmjet të ardhurave të veçanta tatimore dhe jotatimore.

2.7 Fondi i konsoliduar dhe fondet speciale përbëjnë buxhetin e shtetit.

2.8. "Institucione buxhetore" janë të gjitha subjektet, veprimtaria e të cilave financohet nga buxheti i shtetit .

2.9. "Kërkesa për buxhet" është kërkesa për financim me fonde nga buxheti i shtetit, procedurë e cila si rregull fillon nga institucioni buxhetor shpenzues dhe që përgatitet në përputhje me udhëzimet e nxjerra nga Ministri i Financave.

2.10 "Kërkesa për shtesa dhe paksime" është kërkesa për ndryshime në shpërndarjen e fondeve të miratuar në një ose me shumë fonde të tjera që, pasi miratohet nga Këshilli i Ministrave, i dërgohet për shqyrtim Kuvendit Popullor.

2.11 "Numri maksimal i të punësuarve" është numri maksimal i punonjësve të cilët mund të punësohen nga institucionet buxhetore në përputhje me buxhetin e shtetit.

2.12 "Dividentë" janë të ardhurat e realizuara nga përdorimi i kapitalit shtetëror.

2.13 "Shpenzime" janë të gjitha pagesat shtetërore të kryera brenda fondeve të miratuara të buxhetit të shtetit, me përjashtim të pagesave të principalit të kredive.

2.14 "Grant" është e ardhura e përfituar në formën e dhurimit, pa kusht kthimi, pa interes, për një qëllim të përcaktuar ose jo, i cili përdoret për financimin e veprimtarive në përputhje me politika të caktuara.

2.15 "Hua" janë të ardhurat e marra me kusht kthimi me ose pa interes për financimin e projekteve të caktuara brenda fondeve të miratuara ose për financimin e deficitit buxhetor.

2.16 "Interesa dhe komisione" janë shumat e pagueshme kreditorëve në bazë të kushteve dhe afateve të caktura në kontratë, të cilat përfaqësojnë koston e kredive dhe janë pjesë përbërëse e shpenzimeve buxhetore.

2.17 "Principali" është shuma e kredisë pa u përfshirë interesat dhe komisionet.

2.18 Investime janë fonde që përdoren për shpenzime kapitale, për aksione, për letra me vlerë dhe për dhënie kredie.

2.19 "Strukturat buxhetore" është klasifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve në bazë organizative, funksionale, ekonomike, gjeografike sipas burimit të formimit dhe përdorimit.

2.20 "Të hyrat" janë burime të shtetit, por që nuk klasifikohen si të ardhura.

Neni 3

Viti buxhetor është i njëjtë me vitin kalendarik. Viti buxhetor fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti kalendarik.

Neni 4

Të ardhurat e buxhetit të shtetit dhe të hyrat e tjera përbëhen nga:

4.1 Të ardhurat me natyrë tatimore të vendosura me ligj.

4.2 Të ardhurat me natyrë jotatimore, ku përfshihen të ardhurat nga veprimtaritë ekonomike të institucioneve buxhetore, të ardhurat nga dividentët, detyrimet administrative, gjobat, sekuestrimet, konfiskimet, pagesa të huave dhe të ardhura të tjera me natyrë jotatimore sipas ligjit.

4.3 Të ardhurat nga shitja e pronës shtetërore.

4.4 Grante të brenëshme dhe të jashtme si në formën e mjeteve monetare, ashtu edhe në mallra e sherbime

4.5 Huat qeveritare të brenëshme dhe të jashtme për financimin e investimeve dhe të deficitit buxhetor.

4.6 Të ardhura të tjera sipas ligjit.

Neni 5

5.1 Të gjitha të ardhurat e përfituara sipas nenit 4 të këtij ligji formojnë të ardhurat e fondit e konsoliduar.

5.2 Burimet në mjete monetare të fondit të konsoliduar mbahen në një llogari pranë Bankës së Shqipërisë, e cila përcaktohet si llogaria e unifikuar e thesarit. Drejtoria e Thesarit, në rast se kërkohet për një administrim eficient të funksioneve të thesarit, muNë të mbajëë një numër të kufizuar të llogarive të thesarit për të administruar hyrjet dhe daljet në mjete monetare nga llogaria e unifikuar e thesarit.

5.3 Teprica nga fondi i konsoliduar, me autorizim të Ministrit të Financave dhe mbas konsultimit të tij me governatorin e Bankës së Shqipërisë, mund të përdoret për kryerjen e investimeve.

Neni 6

Të ardhurat dhe burimet e tjera financiare të pushtetit lokal përbëhen nga:

6.1 Të ardhurat me natyrë tatimore, ku përfshihen tatimet e taksat që me ligj i lihen pushtetit lokal.

6.2 Transferta të miratuara në buxhetin e shtetit.

6.3 Grante të brendshme dhe të jashtme të cilat administrohen nga organet e pushteit lokal dhe evidencohen në llogarinë e unifikuar të thesarit.

6.4 Të ardhura të tjera të realizuara nga pushteti lokal sipas ligjit.

6.5 Hua të marra nga buxheti i shtetit.

Neni 7

Shpenzimet dhe pagesat e tjera të të gjitha institucioneve buxhetore përbëhen nga:

7.1 Shpenzime korente ku përfshihen pagat, kompesimet, shpërblimet, shpenzimet për mallra dhe shërbime të tjera, transfertat dhe pagesat e interesave.

7.2 Shpenzime kapitale ku përfshihen ndërtimet, rikonstruksionet, blerjet e pasurive kapitale dhe transferime të kapitaleve.

7.3 Huadhënia dhe pjesëmarrja në kapitale me aksione.

7.4 Pagesat e principalit për huamarrjet.

Neni 8

Në shpenzimet e buxhetit lokal përfshihen:

a) Shpenzimet korente, ku përfshihen pagat, shpërblimet, kompensimet. shpenzimet për mallra dhe shërbime të tjera, transfertat dhe pagesat e interesave;

b) Shpenzimet kapitale;

c) Shpenzime të tjera për përmbushjen e kompetencave të përcaktuara me ligj.

Neni 9

9.1 Këshilli i Ministrave nuk ka të drejtë të kryejë asnjë lloj shpenzimi tjetër nga fondi i konsoliduar i cili nuk përfshihet në rastet e përcaktuara në buxhetin e shtetit përveç kur një e drejtë e tillë i njihet me një ligj të posaçëm.

9.2 Në rast se sipas ligjit kërkohet ose lejohet kryerja e pagesave të huave të marra nga Këshilli i Ministrave për të cilat në buxhetin e shtetit nuk është parashikuar fondi posaçëm, Këshilli i Ministrave ka të drejtë të përdorë fondin e konsoliduar për kryerjen e këtyre pagesave.

Neni 10

10.1 Klasifikimi buxhetor, struktura buxhetore dhe parametrat e tjerë teknikë të projektbuxhetit të organeve të pushtetit lokal dhe mënyra e hartimit të tij bëhen në përputhje me këtë ligj, ndërsa të drejtat e pushtetit lokal për buxhetin e tij rregullohen me ligj të vecantë.

10.2 Kërkesat për buxhet lidhur me fondet speciale hartohen, paraqiten dhe miratohen në përputhje me klasifikimin buxhetor, procedurat dhe afatet e përcaktuara në këtë ligj.

Neni 11

Diferenca midis të ardhurave dhe shpenzimeve të vitit buxhetor, duke përjashtuar huamarrjen, do të quhet suficit buxhetor në rastin kur të ardhurat e buxhetit të shtetit janë më të mëdha se shpenzimet e buxhetit të shtetit dhe deficit buxhetor në rastin kur të ardhurat e buxhetit të shtetit janë më të vogla se shpenzimet e buxhetit të shtetetit. Buxheti lokal i organeve të pushtetit lokal nuk munë të jetë me deficit buxhetor.

Neni 12

Ligji vjetor i buxhetit të shtetit duhet të përcaktojë, sipas rastit, mënyrën e përdorimit të suficitit buxhetor ose të financimit të deficitit buxhetor që rezulton nga viti buxhetor paraardhës. Deficiti buxhetor financohet nga burime të brëndëshme ose të jashtme.

KREU II
PARGATITJA, PARAQITJA DHE MIRATIMI I BUXHETIT TË SHTETIT

Neni 13

13.1 Hartimi i projektbuxhetit të shtetit mbështetet në kërkesat e zhvillimit ekonomik, në analizën mbi stabilitetin makroekonomik dhe në politikat e rregullat të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave dhe Ministri i Finaneave.

13.2 Ministri i Financave, përpara fillimit të procesit të hartimit të projektbuxhetit të shtetit, kryen analizat e duhura makroekonomike, të cilat i paraqiten për shqyrtim Këshillit të Ministrave.

13.3 Miratimi i një zëri në buxhetin e shtetit nuk përbën ndonjë detyrim për ta vendosur atë në buxhetin vitit në vazhdim.

Neni 14

Brenda muajit qershor të çdo viti, Ministri i Financave përgatit një raport mbi situatën makroekonomike dhe fiskale të vitit buxhetor në vazhdim. Gjithashtu, Ministri i Financave propozon objektiva lidhur me politikën fiskale dhe bën vlerësimet për kategoritë kryesore të të ardhurave dhe shpenzimeve të vitit buxhetor në vazhdim. Këto raporte i paraqiten për shqyrtim Këshillit të Ministrave.

Neni 15

15.1 Ministri i Financave, mbështetur në vendimet e nxjerra nga Këshilli i Ministrave, brenda datës 10 korrik të çdo viti buxhetor nxjerr udhëzimin për përgatitien e projektbuxhetit nga të gjitha institucionet buxhetore. Ky udhëzim përcakton politikat që do të ndiqen, parametrat që do të përdoren, procedurat dhe afatet për t'u respektuar në përgatltjen e kërkesave për buxhet nga të gjitha institucionet buxhetore.

15.2 Udhëzimi i Ministrit të Financave përcakton të dhënat, formën e tyre dhe afatet e paraqitjes, që duhet të përmbajë projektbuxheti i institucioneve buxhetore si vijon:

a) Parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të projektbuxhetit vjetor të ndarë në kategori shpenzimesh, sipas përcaktimeve në klasifikimin buxhetor të vendosur nga Ministri i Financave.

b) Parashikimi i shpenzimeve dhe të ardhurave për dy vitet buxhetore pasardhës, sipas grupimevetë shpenzimeve që përcaktohen nga Ministri i Financave.

c) Përmbledhja e kërkesave për numrin maksimal të të punësuarve për të cilët kërkohen shpenzime buxhetore, të paraqitur në disa variante, krahasuar me vitin buxhetor në vazhdim.

ç) Relacionin shpjegues për parashikimet e mësipërme, në mënyrë që Ministri i Financave të bëjë analizën e të gjitha propozimeve lidhur me projektbuxhetin.

d) Kërkesat për buxhet, duke përfshirë edhe angazhimet për detyrime për të ardhmen, shpenzimet që do të bëhen për një periudhe disavjeçare duke përfshirë edhe projektet e investimeve, të cilat do të shqyrtohen për secilin vit të ardhshëm buxhetor.

dh) Kërkesat për projektet kapitale të cilat duhet të përfshihen në vitin e ri buxhetor.

Neni 16

16.1 Kërkesat për buxhet të organeve të pushtetit lokal hartohen, paraqiten dhe miratohen duke respektuar kriteret dhe klasifikimet buxhetore të përcaktuara në nenin 15 të këtij ligji.

16.2 Kërkesat per buxhet, lidhur me fondet speciale hartohen, paraqiten dhe miratohen duke respektuar kriteret, klasifikimin buxhetor, si edhe procedurat dhe afatet e përcaktuara në këtë ligj.

Neni 17

17.1 Kërkesat për buxhet të institucioneve buxhetore i dërgohen për shqyrtim Ministrit të Financave, brenda dates 1 shtator të çdo viti buxhetor.

17.2 Ministri i Financave bën analizën e nivelit të të ardhurave, të kërkesave për shpenzime, të

numrit të të punësuarve në institucionet buxhetore, propozon rregullimet e nevojshme, përcakton kërkesat për huat, si dhe shqyrton burimet e nevojshme buxhetore.

17.3 Në rast mosmarrëveshjesh që mund të lindin gjatë diskutimit të projektbuxhetit të shtetit ndërmjet Ministrisë së Financave dhe institucioneve të tjera, Ministri i Financës përgatit një raport të hollësishëm, ku detajohen qëndrimet e dy institucioneve. Kryetari i Këshillit të Ministrave, pasi shqyrton raportin, merr vendimin përkatës.

Neni 18

Ministri i Financave harton projektbuxhetin e shtetit dhe e dërgon për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave brenda muajit tetor të çdo viti buxhetor.

Neni 19

Projektbuxheti i shtetit, i cili paraqitet për shqyrtim dhe miratim, duhet të përmbajë:

19.1 Pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore me treguesit si vijon:

a) Të ardhurat e detajuara të treguara në nenet 4 dhe 6 të këtij ligji.

b) Shpenzimet e detajuara të treguara në nenin 7 të këtij ligji.

c) Gjendjen e fondit të konsoliduar, si dhe të fondeve të tjera përbërës të buxhetit të shtetit në fillim dhe në fund të vitit buxhetor.

19.2 Propozimet e ministrit të financave ndërrmarrjen e masave përkatëse rregullatore në rastin e parashikimit të suficitit buxhetor ose propozimet e tij lidhur me burimet e duhura të financimit në rastin e parashikimit të deficitit buxhetor.. Niveli i deficitit buxhetor do të konsiderohet si nivel maksimal dhe duhet të respektojë kriteret dhe kushtet e treguara në nenet 34 , 35 dhe 36 të këtij 1igji.

19.3 Shpenzimet buxhetore sipas klasifikimit funksional në përputhje me standardet ndërkombëtare.

1 9.4 Të ardhurat dhe shpenzimet sipas të dhënave faktike të vitit buxhetor paraardhës, të dhënat e pritshme të vitit buxhetor në vijim, si dhe.parashikimet për vitin buxhetor pasardhës.

19.5 Parashikime mbi të ardhurat dhe shpenzimet e institucioneve buxhetore të dy viteve buxhetore pasardhës.

19.6 Vlerësim vjetor të shpenzimeve për projektet e investimeve, të cilat zhvillohen për një periudhë më të gjatë se sa një vit buxhetor, duke i bashkëngjitur edhe të dhëna të hollësishme mbi koston e pritëshme të vitit buxhetor ne vazhdim.

19.7 Të ardhurat e parashikuara për qëllime të veçanta dhe shpenzimet përkatëse, si propozime për ndryshime në legjislacion, me qëllim të zbatimit korrekt të projektbuxhetit të shtetit.

Neni 20

20.1 Të ardhurat e parashikuara në projektbuxhetin e shtetit nuk kuifizohen nga niveli i mbledhjes së të ardhurave në zbatimin e tij gjatë vitit buxhetor. Mbledhia e të ardhurave realizohet në përputhje me legjislacionin ekzistues mbi të ardhurat ose me akte të tjera ligjore e nënlgjore të nxjerra gjatë vitit buxhetor.

20.2 Ndryshimet e mundshme të bëra nga Kuvendi Popullor gjatë procesit të miratimit të projektbuxhetit të shtetit duhet të marrin parasysh nivelin e kufirit maksimal të deficitit buxhetor. Çfardo shtesë në nivelin e shpenzimeve buxhetore duhet të shoqërohet me rregullime përkatëse për rritjen e të ardhurave ose për pakësimin e shpenzimeve të tjera në të njëjtën masë me atë të shtesës së nivelit të shpenzimeve buxhetore.

Neni 21

Për të përballuar shpenzimet e paparashikuara në buxhetin e shtetit krijohet fondin rezervë, madhësia e të cilit përcaktohet në ligjin, për buxhetin vjetor të shtetit, por për çdo rast jo më shumë së 3 për qind e totalit të shpenzimeve të parashikuara. Fondi rezervë përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave pas propozimeve të ministrive dhe institucioneve të linjës dhe pas miratimit të dhënë nga Ministri i Financave, Ministri i Financave, në mënyrë periodike, raporton për përdorimin e fondit

rezervë para Kuvendit Populllor.

Neni 22

22.1 Këshilli i Ministrave, pasi shqyrton projektbuxhetin e shtetit dhe e miraton atë, e dërgon për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin Populllor brenda datës 20 nëntor të vitit paraardhës.

22.2 Ministri i Financave, në emër të Këshillit të Ministrave, paraqet përpara Kuvendit Populllor projektbuxhetin e shtetit dhe jep shpjegimet e duhura rreth tij.

22.3 Pas miratimit në Kuvendin Populllor, shuma e shpenzimeve të parashikuara në ligjin për buxhetin e shtetit do të konsiderohet si kufiri maksimal i tyre, duke bërë përjashtim për pagesat e principalit, si dhe të interesave dhe komisioneve për huat qeveritare në përputhje me nenin 9.2. Shpenzimet faktike nuk duhet të tejkalojnë kufijtë maksimalë të përcaktuar në ligjin për buxhetin e shtetit.

22.4 Ndryshimet në ligjin për buxhetin e shtetit bëhen me miratimin e Kuvendit Populllor, sipas propozimit të Këshillit të Ministrave, kur ndryshojnë treguesit kryesorë të të ardhurave të buxhetit të shtetit, të shpenzimeve mbi kufijtë e përcaktuar në nenin 29.2, si dhe të deficitit buxhetor dhe burimeve të financimit të tij.

22.5 Ligji për buxhetin vjetor të shtetit dhe ndryshimet e tij botohen në Fletoren Zyrtare.

22.6 Ministri i Financave shqyrton dhe analizon çfarëdo projektligji lidhur me efektet financiare mbi të ardhurat dhe shpenzimet e parashikuara në buxhetin e shtetit, përpara miratimit të tij nga Kuvendi Populllor.

Neni 23

23.1 Në rast se deri me 31 dhjetor të çdo viti buxhetor Kuvendi Populllor nuk ka miratuar ende projektbuxhetin e shtetit për vitin buxhetor pasardhës, Këshilli i Ministrave miraton dhe zbaton buxhetin e shpenzimeve për një periudhë deri në 3 muaj nga dita e fillimit të vitit të ri buxhetor. Ky buxhet shpenzimesh miratohet dhe zbatohet me qëllim që:

a) Të sigurohet mbulimi i shpenzimeve të institucioneve buxhetore për ushtrimin e veprimtarisë dhe të kompetencave të tyre sipas ligjit.

b) Të përmbushet ushtrimi i veprimtarisë dhe kompetencave të Këshillit të Ministrave, si dhe detyrimet kontraktuale, sipas marrëveshjeve përkatëse.

c) Të zhvillohen dhe zbatohen projektet dhe shërbimet e tjera me kushtin që fondi i miratuar për këtë qëllim të ketë qenë parashikuar në buxhetin e shtetit të vitit buxhetor paraardhës, si dhe të jetë parashikuar në projektbuxhetin e vitit buxhetor pasardhës.

Fondet e miratuara të shpenzimeve për institucionet buxhetore, sipas këtij neni, për secilin muaj nuk duhet të tejkalojnë masën 1/12 të shpenzimeve faktike të kryera në vitin buxhetor paraardhës. Nga fondet e parashikuara nuk mund të vazhdojë financimi për ato lloj shpenzimesh të cilat janë parashikuar të mos jenë në projektbuxhet.

23.2 Me mbarimin e afatit tre mujor, treguar në nenin 23.1 mësipër, shpenzimet buxhetore bëhen vetëm me dekret të veçant të Presidentit të Republikës, por jo më shumë se tre muaj. Brenda këtij afati Kuvendi Populllor duhet të shprehet për projektbuxhetin e vitit.

23.3 Në rast se të ardhurat e parashikuara nuk mbulojnë shpenzimet e përcaktuara në nenin 23.1 më sipër, Këshilli i Ministrave mund të marrë hua fondet e nevojshme për përmbushjen e shpenzimeve korente, por pa tejkaluar për çdo muaj 1/12 e shumës totale të huasë së buxhetit të shtetit të vitit buxhetor paraardhës.

KREU III
ZBATIMI I BUXHETIT TË SHTETIT

Neni 24

24.1 Ministri i Financave, jo më vonë se 20 ditë pas dekretimit të ligjit për buxhetin vjetor të shtetit nga Presidenti i Republikës, bën shpërndarjen e buxhetit të shtetit në institucionet buxhetorë vijuese:

- Organet e larta të pushtetit shtetëror.
- Organet e larta të administraiës shtetërore.
- Organet e pushtetit lokal dhe ato të pushtetit gjyqësor.

24.2 Institucionet buxhetore, të treguara në nenin 24.1 bëjnë shpërndarjen dhe detajimiin e të ardhurave dhe të shpenzimeve buxhetore për të gjitha, institucionet buxhetore në varësi të tyre, në përputhje me politikat e miratuara në, ligjin vjetor të miratuar të buxhetit të shtetit.

24.3 Institucionet buxhetore.janë përgjegjëse për mbledhjen e të ardhurave dhe kryerjen e shpenzimeve buxhetore, në përputhje me parashikimet e për buxhetin e shtetit.

24.4 Në çdo institucion buxhetor, të ngarkuar me funksionin e administrimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve buxhetore, krijohet zyra e buxhetit-financës, kryetari i së cilës emërohet drejtpërdrejt nga drejtuesi i institucionit buxhetor.

24.5 Zyra e buxhet-financës ka për detyrë të kujdeset dhe të përpilojë dokumentacionin e nevojshëm për hartimin e projektbuxhetit, si dhe të organizojë, mbikëqyrë dhe të kontrollojë zbatimin e buxhetit të shtetit. Kjo zyrë, gjithashtu, bën regjistrimin e të gjitha detyrimeve të institucionit buxhetor dhe të atyre në varësi të tij, në përputhje me udhëzimet e nxjerra nga Ministri i Financave.

24.6 Punonjësit e zyrave të buxhet-financës janë të detyruar të respektojnë rregullat, proceduarat dhe afatet ligjore lidhur me buxhetin e shtetit dhe buxhetin lokal. Ata mund të delegojnë kompetenca të tyre, duke mbetur gjithmonë përgjegjës përpara ligjit në rast të mosrespektimit të detyrimeve lidhur me hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.

24.7 Punonjësit e zyrave të buxhet-financës, gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre, janë të detyruar të zbatojnë dhe të mbikëqyrin zbatimin e parimeve të efektivitetit ekonomik dhe ato të drejtimit financier, duke u kujdesur që fondet e miratuara të shpenzohen në kohën e duhur dhe vetëm me qëllimin e një administrimi ekonomik sa më efektiv. Gjithashtu, ata janë të detyruar të kontrollojnë dhe të kërkojnë përmbushjen në kohën dhe masën e duhur të pagesave të detyrimeve, përkatëse, si dhe të marrin masat e nevojshme për sigurimin dhe çeljen e fondeve në përputhje me fondet e miratuara në buxbetin e shtetit

Neni 25

Të gjitha organet shtetërore, të cilat në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore janë të ngarkuara me detyrimin e mbledhjes së të ardhurave, kanë për detyrë të organizojnë punën për mbledhjen e tyre në afatin dhe masën e parashikuar në buxhetin e shtetit. Të ardhurat e mbledhura derdhen dhe mbahen në një llogari të posaçme, të çelur në përputhje me nenin 5.2 të këtij ligji.

Neni 26

26.1 Shpenzimet e secilit institucion buxhetor të treguar në nenin 24.1 të këtij ligji shpërndahen dhe bëhen në përputhje me ndarjen e fondeve të miratuar në afate të caktuara sipas udhëzimeve të Ministrit të Financave. Kjo shpërndarje fondesh bëhet në përputhje me fondet e disponueshme të Këshillit të Ministrave dhe i njoftohet institucioneve buxhetore të lartpërmendura së paku 10 ditë pune përpara asaj të fillimit të afatit të parashikuar për shpërndarjen e fondit. Përpara shpërndarjes së fondit të miratuar, Ministri i Financave mban një rezervë në mason një për qind të atyre fondeve për përballimin e rasteve të paparashikuara.

26.2 Në përputhje me prioritetet e parashikuara prej tyre, institucionet buxhetore, treguar në nenin 24.1 të këtij ligji, nëpërmjet thesarit bëjnë shpërndarjen e fondeve të çelura nga Ministria e Financave për institucionet e tjera buxhetore në varësi të tyre. Të gjitha institucionet janë të detyruara të respektojnë fondet buxhetore të vëna në dispozicion, si kufi maksimal për një periudhë të caktuar buxhetore.

26.3 Institucionet buxhetore, në bazë të fondeve të shpërndara, hyjnë në marrëveshje për blerje mallrash dhe shërbimesh, duke respektuar aktet ligjore dhe nënligjore dhe rregullat e vendosura nga Ministri i Finacave. Bëjnë përjashtim nga ky rregull detyrimet për veprimtari që lidhen me përmbushjen e kontratave, si dhe të investimeve për të cilat është parashikuar se do të vazhdojnë për një afat kohor më të gjatë se viti buxhetor.

26.4 Shpenzimet dhe autorizimet për detyrimet e ardhshme parashikohen dhe përdoren vetëm për qëllimet e përcaktuara në buxhetin e shtetit, për aq kohë sa zgjat realizimi i këtij qëllimi dhe në çdo

rast deri në fund të vitit buxhetor, me të vetmin përjashtim se pagesat e treguara në nenin 33.1 duhet të kryhen brenda 15 ditëve të para të vitit pasardhës buxhetor.

Neni 27

Në përputhje me nenin 21 të këtij ligji, në rastin e nevojave urgjente dhe të paparashikuara për rritjen e shpenzimeve buxhetore, institucionet buxhetore, treguar në nenin 24.1 të këtij ligji, duhet të paraqesin pranë Ministrit të Financave kërkesën për shtesa në buxhet. Këto kërkesa duhet të tregojnë në mënyrë të arsyetuar shumën e fondit të kërkuar dhe mënyrën e llogaritjes së tyre, duke respektuar udhëzimet e Ministrit të Financave.

Neni 28

Institucionet buxhetore, në mënyrën dhe afatet e përcaktuara në udhëzimet e Ministrit të Financave, i raportojnë këtij të fundit në mënyrë të hollësishme për të ardhurat e mbledhura dhe shpenzimet e kryera prej tyre. Përshkrimi i detajuar i transaksioneve të fondeve, që janë në kompetencë të organeve të pushtetit lokal, i raportohet Ministrit të Financave nga organet e tyre përkatëse në përputhje me ligjin për buxhetin lokal. Mbështetur në të dhënat e lartpërmendura, Ministri i Financave përgatit dhe paraqet raportin përkatës në Këshillin e Ministrave.

Neni 29

29.1 Fondet e miratuara të buxhetit të shtetit, mund të rishpërndahen ndërmjet institucioneve buxhetore, treguar në nenin 24.1 të këtij ligji, vetëm me miratim të Këshillit të Ministrave. Kjo rishpërndarje nuk duhet të tejkalojë masën prej 10 për qind të totalit të fondit që shtohet ose pakësohet, duke përjashtuar shtesat nga fondi rezervë.

29.2 Në bazë të propozimit të tyre dhe miratimit paraprak të Ministrit të Finacave, institucionet buxhetore, treguar në nenin 24.1, mund të rishpërndajnë fondet e miratuara brenda buxhetit të tyre midis zërave të shpenzimeve ose institucioneve buxhetore varëse.

Neni 30

Kompetencat e Ministrit të Financave, lidhur me zbatimin e buxhetit të shtetit sipas këtij ligji, në rastin e zbatimit të buxhetit lokal do të ushtrohen nga organet përkatëse të pushtetit lokal, sipas rregullave të parashikuara me ligj të veçantë.

Neni 31

31.1 Brenda muajit korrik të çdo viti buxhetor, Ministri i Financave duhet të paraqesë në Këshillin e Ministrave një raport mbi ecurinë e zbatimit të buxhetit të shtetit, i cili midis të tjerave duhet të përmbajë.

a) Përshkrimin e zhvillimeve të fundit makroekonomike dhe fiskale.

b) Përmbledhjen e gjendjes së të ardhura:ve, të shpenzimeve, të deficitit buxhetor dhe të huamarrjes, krahasuar me nivelet përkatëse të parashikuara në buxhetin e shtetit, duke përfshirë edhe shpjegimet e duhura në rastin e konstatimit të diferencave të mëdha dhe të ndjeshme midis tyre.

c) Propozimet përkatëse të Ministrit të Financave për marrjen e masave të të nevojshme sipas gjëndjes së konstatuar.

Neni 32

32.1 Pas shqyrtimit të raportit treguar në nenin 31 të këtij ligji, Këshilli i Ministrave vendos rrarrjen e masave të nevojshme në përshtatje me zhvillimet e fundit të situatës ekonomike dhe njofton Kuvendin Popullor për këto veprime.

32.2 Në rastin kur masat e marra, sipas nenit 32.1 të këtij ligji, kërkojnë ndryshime në buxhetin e shtetit nëpërmjet përdorimit të fondeve shtesë, zbatohen procedurat e parashikuara në nenin

22.4 të këtij ligji.

Neni 33

33.1 Shpenzimet e fondeve të miratuara të buxhetit të shtetit duhet të kryhen deri në fund të vitit. Pas këtij afati, shlyerja e detyrimeve të papaguara do të kryehet me fondet që do të miratohen për vitin buxhetor pasardhës me perjashtim të rasteve kur situacionet janë marrë me porosi përpara mbarimit të vitit buxhetor të mëparshëm, rast në të cilin pagesa mund të bëhet deri më datën 15 janar të vitit buxhetor pasardhës.

33.2 Çfarëdo e ardhur e realizuar pas mbarimit të vitit buxhetor duhet të regjistrohet si e ardhur për buxhetin e shtetit të vitit buxhetor pasardhës, me përjashtim atyre të ardhurave që me ligj të veçantë vendoset ndryshe.

KREU IV
HUAT DHE BORXHET E SHTETIT

Neni 34

34.1 Në ligjin vjetor të buxhetit të shtetit duhet të vendoset një kufi për rritjen vjetore të totalit ekzistues të borxhit të shtetit, duke përfshirë çdo projekt-marrëveshje në përputhje me nenin 5.3 të këtij ligji, si dhe borxhet te të tretët, të marra përsipër nga shteti.

34.2 Huat e marra nga Banka e Shqipërisë i nënshtrohen kufizimeve të përcaktuara në ligjin nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë".

34.3 Ligji vjetor i buxhetit të shtetit vendos një kufi të veçantë të garancive të shtetit në dobi të palës së tretë përfituese.

Neni 35

35.1 Këshilli i Ministrave është i vetmi autoritet që ka të drejtën e marrjes së huave nga institucionet ndërkombëtare, shtete të ndryshme, persona juridikë ose fizikë, në përputhje me dispozitat kushtetuese dhe me ligjet në fuqi. Ai është i vetmi organ që jep garanci për institucionet ndërkombëtare, shtetet e ndryshme, personat juridikë dhe fizikë për huat e marra, në përputhje me dispozitat kushtetuese dhe me ligjet në fuqi.

35.2 Subjektet përfaqësuese të fondeve speciale dhe organet e pushtetit lokal mund të marrin hua vetëm nga buxheti i shtetit brenda fondit të posaçëm të parashikuar për këtë qëllim në buxhetin e shtetit.

Neni 36

36.1 Huat shtetërore mund të jenë në formën e marrëveshjeve të huasë, të bonove të thesarit ose të regjistrimeve në librin e llogarive dhe instrumenteve të tjera të njohura me ligj. Përshkrimi i të dhënave për zotëruesit e bonove mbahen nga Banka e Shqipërisë në emër të Këshillit të Ministrave ose nga institucionet financiare të autorizuara nga Banka e Shqipërisë.

36.2 Parimet e përcaktuara në ligj për letrat me vlerë janë të zbatueshme për borxhin e emetuar ose të regjistruar në librin e llogarive.

Neni 37

Në fondin e konsoliduar të buxhetit të shtetit parashikohet përmbushja e pagesave për të gjitha interesat, komisionet dhe principalet e huave dhe garancive shtetërore sipas kushteve dhe afateve të treguara në marrëveshjet përkatëse të lidhura për këtë qëllim nga Këshilli i Ministrave.

Neni 38

38.1 Ministri i Financave vepron lidhur me borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore në

zbatim të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, të nxjerrë në përputhje dhe brenda kufijve të parashikuar në ligjin për buxhetin e shtetit. Ministri i Financave përfaqëson Këshillin e Ministrave në të gjitha marrëveshjet mbi huat dhe garancitë shtetërore.

38.2 Ministri i Financave kryen veprimet për huamarrjen në formën e përshtatshme për të dhe për huadhënësin dhe ka të drejtën e zgjedhjes së llojit të instrumenteve financiare, karakteristikave dhe kushteve të tyre. Në kryerjen e veprimeve të tij si më sipër, në përputhje me politikat monetare, Ministri i Financave merr paraprakisht mendimin e guvernatorit të Bankës së Shqipërisë.

38.3 Në bazë të një marrëveshjeje të lidhur me Ministrin e Financave, Banka e Shqipërisë merr përsipër të kryejë veprimet e nevojshme për zbatimin e akteve lidhur me borxhin shtetëror.

Neni 39

Ministri i Financave bën evidentimin dhe regjistrimin pranë saj të të gjitha borxheve, garancive dhe huave shtetërore dhe përgjigjet për administrimin e tyre. Ministri i Financave përgjigjet për mbajtjen dhe kontrollin e brendshëm të llogarive të borxheve shtetërore dhe të transaksioneve të kryera nga Këshilli i Ministrave në lidhje me borxhet shtetërore.

Neni 40

40.1 Këshilli i Ministrave nuk ka të drejtë që, në mënyrë të njëanshme, të ndryshojë kushtet për kontraktimin e borxhit shtetëror të parashikuar nga ky ligji. Përjashtim bëhet në rastin kur ofrohen kushte të ndryshuara me karakter të përgjithshëm për të gjithë kreditorët. Megjithatë, vlefshmëria e tyre për secilin kreditor është e kushtëzuar me miratimin dhe pranimin tyre nga vetë kreditori.

40.2 Aktet e Këshillit të Ministrave ose të Ministrit të Financave, që përmbajnë kushtet e përnmbushjes ose çdo transaksioni të borxhit shtetërot, botohen në Fletoren Zyrtare.

KREU V
LLOGARIA BANKARE, INSPEKTIMI DHE REVIZIONI

Neni 41

41.1 Ministri i Financave nxjerr udhëzimet dhe kontrollon zbatimin e procedurave standarde mbi mbajtjen e llogarive, mbi kërkesat dhe mënyrën e paraqitjes së tyre nga të gjitha institucionet buxhetore.

41.2 Ministri i Financave nxjerr udhëzimet përkatëse për çdo kategori të klasifikimit buxhetor dhe për çdo institucion buxhetor.

41.3 Të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit të shtetit regjistrohen me terma bruto, pavarësisht se shuma përkatëse është debituar në fondin e konsoliduar apo kredituar në atë fond.

Neni 42

42.1 Drejtuesit e institucioneve buxhetore, të treguara në nenin 24.1 të këtij ligji, ushtrojnë kontrollin e brendshëm dhe kontabël mbi të gjitha transaksionet që lidhen me të ardhurat dhe shpenzimet buxhetore të institucioneve buxhetore, që drejtojnë apo që janë në varësi të tyre.

42.2 Ministri i Financave, në përputhje me procedurat e vendosura me një udhëzim të veçantë të nxjerrë prej tij, në afate periodike ose të paparashikuara, ushtron kontroll për mbajtjen dhe regjistrimin në llogaritë përkatëse të të ardhurave dhe shpenzimeve nga të gjitha institucionet buxhetore.

Neni 43

Para mbarimit të vitit buxhetor, Ministri i Financave nxierr udhëzimet për procesin e mbylljes përfundimtare të llogarive të të ardhurave dhe të shpenzimeve buxhetore të të gjitha institucioneve buxhetore.

Neni 44

Punonjësit e zyrave të buxhet-financës të secilit institucion buxhetor hartojnë bilancin përfundimtar të gjendjes së të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore të tyre dhe e depozitojnë atë pranë institucionit buxhetor përkatës epror, të treguar në nenin 24.1 në këtë ligji, brenda datës 1 mars të çdo viti buxhetor.

Neni 45

Institucionet buxhetore, treguar në nenin 24.1 të këtij ligji, në bazë të analizës së kryer hartojnë bilancin përfundimtar të të ardhurave dhe shpenzimeve të institucioneve buxhetore varëse, bëjnë rregullimet e duhura të llogarive deri në hartimin e bilancit përfundimtar të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore të fushës së veprimtarisë dhe kompetencës së tyre, të cilat depozitohen pranë Ministrit të Financave brenda datës 31 mars të çdo viti buxhetor.

Neni 46

Në bazë të analizës së kryer mbi bilancet përfundimtare të të ardhurave dhe shpenzimeve faktike të institucioneve buxhetore, treguar në nenet 44 dhe 45 të këtij ligji, Ministri i Financave brenda datës 15 maj të çdo viti buxhetor harton bilancin përfundimtar të gjendjes faktike të të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit të shtetit të vitit paraardhës.

Neni 47

Mjetet monetare të fondeve buxhetore të çelura nga Ministri i Financave për institucionet i buxhetore dhe të papërdorura prej tyre kthehen në fondin e konsoliduar brenda datës 31 dhjetor të çdo viti buxhetor, përveç kur Ministri i Financave vendos ndryshe.

Neni 48

48.1 Bilanci përfundimtar i gjendjes faktike të të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit të shtetit, i hartuar në përputhje me përmbajtjen dhe klasifikimin buxhetor të treguar në nenet 19.1 deri 19.5 të këtij ligji, ndër të tjera përmban:

a) Gjendjen faktike të fondit të konsoliduar në fillim dhe në mbarim të vitit buxhetor.

b) Relacion shpjegues për mospërputhjet kryesore.

c) Raport për të gjitha huat shtetërore dhe operacionet e tjera të lidhura me borxhin shtetëror.

ç) Raport për shpenzimin e fondit rezervë të parashikuar në buxhetin e shtetit dhe për garancitë e dhëna gjatë vitit buxhetor.

Neni 49

Bilanci përfundimtar i gjendjes faktike të të ardhurave dhe të shpenzimeve të buxhetit të organeve të pushtetit lokal hartohet prej tyre në përputhje me përshkrimet e treguara në nenin 48 të këtij ligji.

Neni 50

Bilanci përfundimtar i gjendjes faktike të të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit të shtetit i praqitet Këshillit të Ministrave nga Ministri i Financave dhe, pas shqyrtimit të tij, i dërgohet për miratim Kuvendit Popullor brenda muajit qershor të çdo viti buxhetor.

KREU VI
DISPOZITA TË TJERA

Neni 51

Shkeljet e mëposhtme, kur nuk formojnë vepër penale përbëjnë kundërvajtje administrative:
1. Mosrespektimi i afatit të parashikuar në nenin 17.1 dhe 45 të këtij ligji.
2. Përdorimi i fondeve në kundërshtim me kushtet e parashikuara në nenin 24.7 të këtij ligji.
3. Tejkalimi i fondeve, qoftë edhe i përkohshëm, në kundërshtim me nenin 26.2 të këtij ligji.

Neni 52

Për kundërvajtjet administrative të parashikuira në nenin 51 të këtij ligji, përveç shpërblimit të dëmit të shkaktuar, ndaj kundërvajtësve jepet dënimi administrativ me gjobë nga 5000 lekë deri 50 000 lekë.

Dënimi administrativ me gjobë vendoset nga Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit në Ministrinë e Financave.

Kundër vendimit të dënimit me gjobë brenda 5 ditëve nga dita e shpalljes ose e njoftimit të tij, kundërvajtësi mund të bëjë ankim tek Ministri i Financave i cili, brenda 10 ditëve nga marrja e ankimit vendos për lënien në fuqi, ndryshimin ose heqjen e dënimit administrativ.

Kundër vendimit të Ministrit të Financave mund të bëhet ankim brenda 10 ditëve në gjykatën e shkallës së parë.

Procedurat, afatet dhe mënyra e konstatimit, shqyrtimit, ankimit dhe ekzekutimit të dënimeve administrative me gjobë bëhen në përputhje me ligjin nr.7697, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative".

Neni 53

Ministri i Financave nxjerr urdhra, udhëzime dhe rregullore në bazë dhe për zbatim të këtij ligji.

Neni 54

Ligji nr.7616, datë 30.9.1992 "Për miratimin me ndryshime të dekretit nr.266, datë 22.7.1992 "Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në Republikën e Shqipërisë", si edhe çdo dispozitë ligjore apo nënligjore që vjen në kudërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 55

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2181, datë 11.8.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani